


# NEWSLETTER E DIASPORËS

PERFAQËSIMI DHE NËXTITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDRËVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NËXTUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHITETET KU ATA BANOJNË

#113



## Takimi i mësuesve në Diasporë, sfidat dhe problematikat e arsimit jashtë vendit



Qendra e Botimeve për Diasporën organizoi për herë të parë “Takimin e Mësuesve të Diasporës”. Ky takim i pari në historinë e mësimdhënies së gjuhës shqipe në Diasporë kishte të ftuar mësues që trajtuan problematika të ndryshme që lidhe me mësimin e gjuhës shqipe në Diasporë, para dhe gjatë pandemisë. Të pranishëm në aktivitet ishte edhe Ministri i Shtetit për Diasporë, Pandeli Majko, Ministri i Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Kosovë Arbërie Nagavci, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Evis Kushi. Gjithashtu përfaqësues nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në Kosovë, si dhe përfaqësues nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme Shqipëri.

“Takimin e Mësuesve të Diasporës” ishte aktiviteti i radhës i Qendrës së Botimeve për Diasporën, synimi i së cilës është krijimi i një strukture të konsoliduar për mësimdhënien e gjuhës shqipe në Diasporë.



## "Apliko online për rinovimin e dokumenteve biometrike"

Shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë tashmë kanë mundësi të aplikojnë për rinovimin e dokumentave të tyre biometrike, si dhe të deklarojnë adresën e tyre të vendbanimit online.

## Takimi i mësuesve në Diasporë, ministri Majko: Jemi në fazën e miratimit të teksteve

Në Tiranë është mbajtur takimi i parë i mësuesve në Diasporë, ku të ftuar janë mësues të cilët trajtojnë problematika të ndryshme që lidhe me mësimin e gjuhës shqipe në Diasporë, para dhe gjatë pandemisë.

Në fjalën e tij ministri i shtetit për Diasporën Pandeli Majko duke vlerësuar bashkëpunimin mes Shqipërisë dhe Kosovës përse ia përket mësimdhënies në Diasporë tha se aktualisht janë në fazën e miratimit të teksteve të përbashkëta.

“Tani jemi në fazën e miratimit të teksteve. Mendoj se kemi nisur këtë punë duke pasur vetëm një abetare të përbashkët dhe aktualisht po punojmë që me shpresë pasi është në dorë të ekspertëve dhe atyre që ia dinë kësaj pune vitin tjetër arsimor, jo në shtator të këtij viti po tjetrit të nisim punën me librat e rinj të përbashkët për mësimdhënien në diasporë të miratuar nga të dyja ministratë e Arsimit në Shqipëri dhe Kosovë, tha ndër të tjera ministri Majko



Është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionet e ndryshme në Diasporë

## Drejtoresha e QBD, Mimoza Hysi: Sfidë, realizimi i marrëveshjeve dypalëshe



Në takimin e organizuar ditën e sotme me mësuesit në Diasporë drejtoresha e Qendrës së Botimeve për Diasporën, znj. Mimoza Hysa u ndal tek rëndësia e tekstit të përbashkët mes Shqipërisë dhe Kosovës për shqiptarët në Diasporë.

“Dy vite më parë Qendra e Botimeve për Diasporën u prezantua në Seminarin e mësuesve në Prizren me një listë premtimesh dhe dëshirash. Sot mund të themi se përveç që kemi realizuar një pjesë të tyre, jemi kthyer në një pikë referimi për mësuesit në Diasporë, me një staf që njihet dhe adreson me përgjegjësi problematikat e ndryshme për zgjidhje në institucionet që kanë në fokus mësimdhënien në diasporë. Premtuam se do të siguronim tekste për mësuesit në diasporë dhe arritëm në dy vite të dërgonim rreth 30 mijë tekste, për më tepër duke ndryshuar praktikën e punës: në dy vite teksteve kanë shkruar në 22 vende të botës në kohë rekord, brenda shtator, para fillimit të vitit të ri shkollor duke vendosur kështu një standard të ri”, tha ajo.



Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjeve si agjentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online

## Mësuesit jashtë vendit: Diaspora nuk njeht kufi, gjuha shqipe është një

Në pjesën e dytë të takimit të organizuar ditën e sotme me mësuesit në Diasporë panelistët referuan tema e tyre me fokus “Çështje të organizimit të mësimdhënies në Diasporë”.

Ky takim i pari në historinë e mësimdhënies së gjuhës shqipe në Diasporë ka të ftuar mësues të cilët do të trajtojnë problematika të ndryshme që lidhe me mësimin e gjuhës shqipe në Diasporë, para dhe gjatë pandemisë si: Drita Gjongecaj (SHBA) e cila do të ndalet te “Trajnimet e mësuesve të Diasporës, Anila Kadrija (Britani e Madhe): Si të punojmë me Fantazinë e fëmijëve duke bashkëpunuar me prindër dhe profesionistë vendas, Teuta Tabaku: Kultivimi, organizimi i mësimi të gjuhës shqipe për brezat e ndryshëm në Diasporë, Mustafë Krasniqi (Gjermani): Nxënësi, Prindi, Shoqëria de Shteti, Dritan Mashi (Itali); Ku jemi ne, me mësimin e gjuhës shqipe në Itali, Qemal Zylo (SHBA); Përvoja e shkollës shqipe “Alba Life” në USA në rritjen e cilësisë në mësimdhënie, Mimoza Bejkollari (Zvicër):



## Digjitalizimi i Veprave Shqiptare

Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

## Botohet Periodiku i parë për vitin 2021, “Diaspora Shqiptare”



Fondi Shqiptar i Zhvillimit të Diasporës ka publikuar sot Periodikun “Diaspora Shqiptare”, Analiza dhe Studime, një përmbledhje e çështjeve më të rëndësishme që lidhen me dinamikën e Diasporës shqiptare. Ky është një botim që realizohet dy herë në vit dhe përmban raporte, analiza, studime. Fenomene që lidhe me Diasporën shqiptare.

Në këtë botim të sapo publikuar gjenden analiza të realizuara nga Banka e Shqipërisë, Instituti i Statistikave, Banka Botërore, si dhe punime shkencore nga akademikë dhe kërkues shkencorë, ku në fokus janë “Raportimet e koordinatorëve shtetëror 2020”.



Burgu nuk është vetëm një vend për vuajtjen e dënimit, por mund të jetë edhe letërsi, studim, rritje e njohjeve kulturore dhe ndërveprim. Nisma “Dhuro libra” do të shërbejë për krijimin e një fondi me libra shqiptarë në institucionet e vuajtjes së dënimit në Greqi dhe Itali.

## “Digi Diaspora”/ Mbahet takimi i tretë me ekspertë të teknologjisë

Në takimin e tretë të Digi Diaspora me përfaqësues të suksesshëm të industrisë digjitale të Diasporës të ftuarit ndanë eksperiencat dhe njohuritë e tyre në fushën e teknologjisë.

Inxhinieri shqiptar Ermal Sadiku, themelues i kompanisë “Linkplus IT”, i cili ka kryer studimet pasuniversitare në “Offenburg University” në Gjermani, tregoi rreth përvojës së tij të gjatë arsimore dhe profesionale.

Ai u shpreh se zgjidhi të studiojë në Gjermani për shkak të arsimit mjaft cilësor në fushën e tij të ekspertizës dhe theksoi se Diaspora shqiptare, ka luajtur një rol themelor në zhvillimin e biznesit të tij dhe ka qenë ajo që i ka hapur rrugët për bashkëpunim, duke ndikuar në suksesin e arritur.



## Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"



App store: këtu Play store: këtu

## QSPA dhuron libra për institucionet kërkimore-shkencore në Prishtinë



Në vazhdim të aktiviteteve të realizuara këtë javë në Madeqoninë e Veriut dhe në Kosovë, Drejtoresha Ekzekutive e QSPA-së, Prof. Diana Kastrati, së bashku me studiuesit Dr. Vilma Proko dhe Dr. Edmond Cane, kanë dhuruar libra për Institutin Albanologjik të Prishtinës, Bibliotekën Kombëtare të Kosovës “Pjeter Bogdani” dhe Institutin Arkeologjik të Kosovës. Drejtoresha Kastrati dhe studiuesit Proko e Cane zhvilluan takime me përfaqësues të këtyre institucioneve dhe prezantuan disa nga objektivat dhe punët kryesore të realizuara deri më tani nga QSPA, si dhe botimet dhe veprimtaritë për vitin e parashikuar të realizohen në vitin 2021 dhe në vijim.